**VENDIM**
**Nr. 313, datë 15.4.2015**

# PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES SË AUTORIZIMIT PËR MAGAZINIMIN, TRANSFERIMIN DHE ASGJËSIMIN E LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL DHE LËNDËVE PIROTEKNIKE FISHEKZJARRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7/1, pika 3, e 9, pika 1, të ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003, "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim përcakton rregullat për procedurat e dhënies së autorizimit dhe kontrollin e veprimtarisë së magazinimit, transferimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil dhe lëndëve piroteknike fishekzjarrë.

II. MAGAZINIMI I LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL DHE LËNDËVE PIROTEKNIKE E FISHEKZJARRËVE

1. Magazinimi i lëndëve plasëse për përdorim civil në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të kryhet vetëm nga subjektet e pajisura me licencë për import, eksport dhe prodhim të lëndëve plasëse për përdorim civil, lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, ose nga subjektet e pajisura me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse, lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

2. Përpara pajisjes me licencë, subjekti duhet të pajiset me autorizimin për miratimin e depos për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorimcivil.

3. Përpara pajisjes me autorizim për përdorimcivil të lëndëve plasëse nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, subjekti duhet të ketë depo për lëndët plasëse, të miratuar nga Komisariati i Policisë që mbulon territorin ku është ndërtuar depoja ose kontratë me një subjekt që ka depo të lëndëve plasëse të miratuar. Kontrata duhet të jetë e miratuar nga Komisariati i Policisë që mbulon territorin ku kryhet veprimtaria.

4. Për pajisjen me autorizimin për miratim të depos për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorimcivil, duhet të plotësohen këto kritere:

a) Subjekti të jetë subjekt tregtar i regjistruar në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi;

b) Subjekti të ketë ambientin depo në pronësi apo në përdorim, sipas një kontrate qiraje/nënqiraje ose huapërdorimi;

c) Ambienti i depos të jetë i përcaktuar me destinacionin "magazinim lëndësh plasëse për përdorim civil" apo, në rastet kur ambienti është i adaptuar, të ketë projektin teknik të magazinës së lëndëve plasëse të miratuar nga Reparti i Inspektim-Shpëtim-Minierave (RISHM);

ç) Ambienti i destinuar për depo të plotësojë kushtet për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, sipas përcaktimeve në rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë (rrethimi, ndriçimi, mjetet mbrojtëse nga zjarri, siguria e dyerve dhe dritareve, vendroja për ruajtjen e depos, mjetet dhe tabelat sinjalizuese, sigurimi nga shkarkimet atmosferike);

d) Ambienti i destinuar për depo duhet të ketë projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtim, si dhe ky ambient të ketë të përshtatura masat e mbrojtjes nga zjarri, në përputhje me këtë projekt;

dh) Të jetë i kontraktuar një subjekt i SHPSF-së për ruajtjen e magazinës.

5. Kërkesa për miratimin e depos për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil shqyrtohet nga Komisariati i Policisë që ka juridiksionin mbi territorin ku ndodhet depoja.

6. Në kërkesën për miratimin e depos për magazinimin e lëndëve plasëse, përveç të dhënave për subjektin, duhet të përcaktohen:

a) vendndodhja e saktë e depos;

b) lloji i lëndës plasëse sipas kategorive, lëndë plasëse dhe/ose materiale plasëse (kapsolla elektrike, joelektrike dhe fitil) për të cilat kërkohet autorizimi;

c) kapaciteti maksimal mbajtës i depos, i detajuar në lëndë plasëse dhe/ose materiale (kapsolla elektrike, joelektrike dhe fitil), për të cilën kërkohet autorizimi;

ç) afati i përdorimit të depos.

7. Së bashku me kërkesën e plotësuar, subjekti duhet të paraqesë edhe këto dokumente shoqëruese:

a) Ekstraktin e gjendjes aktuale, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

b) Fotokopjen e dokumentit të pronësisë të noterizuar, nëse është pronë e subjektit, ose dokumentin që vërteton të drejtën e përdorimit, nëse është në pronësi të një të treti;

c) Nëse ambienti është i adaptuar, vërtetimin nga RISHM-ja, që përcakton se objekti i plotëson kushtet për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, sipas përcaktimeve në rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë;

ç) Aktin teknik nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit;

d) Autorizimin nga agjencia rajonale për mbrojtjen e mjedisit;

dh) Kontratën me subjektin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe fotokopjen e autorizimit të mbajtjes së armës së zjarrit të punonjësit/punonjësve që do të ruajnë magazinën.

8. Afati për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e depos është 25 ditë.

9. Titulli i autorizimit për miratimin e depos për magazinim të lëndëve plasëse për përdorimcivil përcakton:

a) të dhënat e identifikimit të subjektit;

b) vendndodhjen e saktë të depos;

c) afatin e vlefshmërisë së autorizimit;

ç) llojin e lëndës plasëse;

d) kapacitetin maksimal të lejuar të magazinimit;

dh) numrin e vendrojeve për ruajtjen e depos.

10. Pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, të këtij kreu, zbatohen dhe për miratimin e depove për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë.

III. TRANSFERIMI I LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL

1. Transferimi i lëndëve plasëse për përdorim civil mund të kryhet vetëm nga subjektet e pajisura me licencë për import, eksport dhe prodhim të lëndëve plasëse për përdorim civil, lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, ose nga subjektet e pajisura me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse, lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

2. Autorizimi për transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil kërkohet për çdo ngarkesë që transferohet, si dhe për çdo mjet që bën transportin e ngarkesës.

3. Për pajisjen me autorizim për transferim të lëndëve plasëse për përdorimcivil, duhet të plotësohen këto kritere:

a) Subjekti të jetë i pajisur me licencën për import, eksport dhe prodhim të lëndëve plasëse për përdorim civil nga Ministria e Mbrojtjes apo me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse, lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë;

b) Personi që do të shoqërojë lëndën plasëse duhet të ketë dëshminë e zjarrmëtarit;

c) Subjekti të ketë në pronësi apo në përdorim depo për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, të miratuar sipas këtij vendimi;

ç)Drejtuesi i automjetit, që kryen transportin, të jetë i pajisur me certifikatë "ADR", sipas legjislacionit në fuqi "Për transportin e lëndëve të rrezikshme";

d) Automjeti, që kryen transportin, të jetë i pajisur me certifikatë "ADR" e sipas ligjit "Për transportin e lëndëve të rrezikshme";

dh) Automjeti, që kryen transportin, të jetë i pajisur me GPS funksional për kontrollin dhe

dokumentimin e itinerarit në subjektin që bën transferimin;

e) Të jetë kontraktuar një subjekt i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike që do të kryejë shoqërimin e lëndës plasëse për përdorim civil, gjatë transferimit;

ë) Automjeti, që kryen transportin, të jetë i pajisur me aktin teknik nga strukturat e PMNZSH-së të qarkut, me shenjat konvencionale treguese për transport të lëndëve plasëse, si dhe fikëse zjarri jo më të vogla se 6 kg dhe jo më pak se 2 (dy) copë.

4. Rastet kur transferimi i mallit do të kryhet nga transportuesit e huaj me mjetet e tyre të transportit, të pajisur me certifikatë "ADR" në vendet e origjinës, si dhe rastet e transitimit të këtyre mallrave nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë përjashtohen nga shkronja "ë", e pikës 3, të këtij kreu.

5. Kërkesa për autorizimin e transferimit të lëndëve plasëse për përdorimcivil shqyrtohet nga Komisariati i Policisë ku subjekti zhvillon aktivitetin.

6. Në kërkesën për autorizimin e transferimit të lëndëve plasëse për përdorimcivil, përveç të dhënave të subjektit, duhet të përcaktohen:

a) pika e kontrollit të kalimit kufitar, nga ku do të hyjë apo do të dalë lënda plasëse, orari përkatës dhe itinerari i lëvizjes (për transportin nga brenda/jashtë vendit) dhe vendi ku do të magazinohet;

b) sasia/lloji i lëndëve plasëse për përdorim civil;

c) të dhënat e identifikimit të punonjësit zjarrmëtar;

ç) të dhënat e punonjësit të SHPSF-së që do të shoqërojë transferimin e ngarkesës;

d) të dhënat e identifikimit të drejtuesit të automjetit;

dh) tipi dhe targa e automjetit.

7. Së bashku me kërkesën e plotësuar, kërkuesi duhet të paraqesë edhe këto dokumente shoqëruese:

a) Licencën për import, eksport dhe prodhim të lëndëve plasëse për përdorim civil, të lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, apo autorizimin për përdorim civil të lëndëve plasëse, të lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë;

b) Dëshminë e zjarrmëtarit;

c) Kontratën me subjektin e SHPSF-së dhe fotokopjen e autorizimit të mbajtjes së armës së zjarrit të punonjësit që do të kryejë shoqërimin gjatë transferimit të lëndëve plasëse për përdorim civil;

ç) Certifikatën e miratimit të mjetit "ADR", të lëshuar nga institucioni përkatës, sipas nenit 37, të ligjit nr. 118/2012, "Për transportin e lëndëve të rrezikshme";

d) Certifikatën e vlefshme "ADR" të drejtuesit të mjetit që do të bëjë transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, sipas ligjit nr. 118/2012, "Për transportin e lëndëve të rrezikshme".

8. Afati për shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e autorizimit për transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil brenda vendit bëhet brenda 7 ditëve, ndërsa kur lënda plasëse për pëdorim civil do të importohet ose eksportohet, afati për shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e autorizimit për transferim bëhet brenda 15 ditëve.

9. Titulli i autorizimit për miratim të transferimit të lëndëve plasëse për përdorimcivil duhet të përcaktojë:

a) të dhënat e subjektit;

b) itinerarin e lëvizjes e të destinacionit të depos;

c) llojin e lëndës e të materialeve plasëse që do të transferohen dhe sasinë përkatëse;

ç) të dhënat e automjetit që do të bëjë transferimin e lëndës dhe materialeve plasëse;

d) të dhënat e drejtuesit të automjetit;

dh) kohën në të cilën do të bëhet transferimi;

e) të dhënat e zjarrmëtarit që do të shoqërojë lëndën plasëse;

ë) të dhënat e punonjësve të SHPSF-së.

IV. ASGJËSIMI I LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL TË SKADUARA

1. Asgjësimi i lëndëve plasëse për përdorim civil të skaduara mund të kryhet vetëm nga ato subjekti që plotëson këto kritere:

a) Të jetë i pajisur me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse, lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë;

b) Të ketë përcaktuar vendin ku do të asgjësohen lëndët plasëse për përdorim civil të skaduara;

c) Të ketë përcaktuar drejtuesin teknik të punimeve, që do të bëjë asgjësimin;

ç) Të ketë përcaktuar sasinë e lëndës plasëse që do të asgjësohet, të ndarë në kapsolla dhe fitila;

d) Të jetë i pajisur me autorizim nga Agjencia Rajonale për Mbrojtjen e Mjedisit;

dh) Të jetë i pajisur me aktin teknik nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit;

e) Të ketë përgatitur aktvlerësimin teknik për sigurimin e jetës së njerëzve, kafshëve dhe vlerave materiale përreth.

2. Subjektet e pajisura me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse duhet të paraqesin kërkesën për autorizim për asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil të skaduara, pranë Komisariatit të Policisë që ka juridiksionin mbi vendin ku do të bëhet asgjësimi.

3. Komisariati i Policisë, brenda 25 ditëve, miraton ose refuzon kërkesën për autorizim të subjektit, sipas kritereve të përcaktuara në pikën 1.

4. Në autorizimin për asgjësim të lëndëve plasëse për përdorimcivil të skaduara duhet të përcaktohen:

a) të dhënat e subjektit;

b) vendndodhja e saktë e asgjësimit;

c) lloji dhe sasia e lëndës plasëse për të cilën miratohet asgjësimi;

ç) të dhënat e drejtuesit teknik të punimeve, që do të bëjë asgjësimin e lëndëve plasëse;

d) data e fillimit dhe data e mbarimit të asgjë-simit të lëndës plasëse.

V. BESUESHMËRIA

1. Ministria e Mbrojtjes pajis personin juridik apo fizik me licencë për import, eksport dhe prodhim të lëndëve plasëse për përdorim civil dhe lëndëve piroteknike fishekzjarrë, pasi të jetë pajisur me vërtetim besueshmërie, të lëshuar nga Komisariati i Policisë ku i interesuari ka vendbanimin.

2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë pajis personin juridik apo fizik me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse, pasi të jetë pajisur me vërtetim besueshmërie, të lëshuar nga Komisariati i Policisë ku i interesuari ka vendbanimin.

3. Përfaqësuesi ligjor i personit juridik apo fizik (subjekti), që të ushtrojë veprimtarinë me lëndët plasëse për përdorim civil, duhet të plotësojë këto kritere:

a) Të mos ketë qenë i dënuar më parë me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje;

b) Të mos ketë qenë apo të jetë i evidentuar për raste të kundërshtimit me dhunë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, nëpunësve publikë ose për veprat penale të dhunës në familje, për çështje me objekt të hakmarrjes ose gjakmarrjes;

c) Të jetë i aftë nga ana fizike e mendore;

ç) Të gëzojë besueshmëri, sipas ligjit.

4. Verifikimi i kritereve të sipërpërmendura bëhet nga Komisariati i Policisë ku subjekti zhvillon aktivitetin, në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushat përkatëse, nëpërmjet këtij dokumentacioni:

a) Letërnjoftimit të personit që kërkon të ushtrojë veprimtarinë me lëndë plasëse për përdorim civil;

b) Raportit mjekësor ku të vërtetohet gjendja fizike dhe psikike;

c) Certifikatës së gjendjes gjyqësore;

ç) Vërtetimit të besueshmërisë së shtetasit;

d) Dy fotografi 6x4 cm;

dh) Për shtetasit e huaj, vërtetimit të gjendjes gjyqësore nga vendet në të cilat ka pasur vendbanimin apo vendqëndrimin në 10 vitet e fundit (vetëm në origjinal).

5. Të interesuarit i kthehet përgjigjja me shkrim nëse i plotëson ose jo kriteret ligjore, brenda 15 ditëve, dhe dokumenti i vërtetimit të besueshmërisë mbahet në dosjen e subjektit.

VI. RAPORTIMI I TË DHËNAVE PËR SUBJEKTET E LICENCUARA PËR IMPORT, EKSPORT, PRODHIM DHE PËR PËRDORIM CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE

1. Ministria e Mbrojtjes dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike të dhënat e subjekteve të regjistruara në regjistrin shtetëror për lëndët plasëse, sipas pikave të mëposhtme:

a) Një kopje të licencës së importit, eksportit të lëndëve plasëse në momentin e lëshimit;

b) Çdo tre muaj, një kopje të regjistrit shtetëror të lëndëve plasëse për përdorim civil, me shkresë zyrtare dhe në mënyrë elektronike.

2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike një kopje për çdo autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse, të lëshuar subjekteve.

VII. KONTROLLI I SUBJEKTEVE QË USHTROJNË VEPRIMTARI ME LËNDË PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL

1. Policia e Shtetit, Ministria e Mbrojtjes, Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit, Reparti i Inspektim-Shpëtim Minierave dhe institucionet e tjera të specializuara shtetërore, të parashikuara me ligj, për qëllimet e përcaktuara në këtë vendim dhe në rregulloren e ministrit të Punëve të Brendshme, kanë të drejtë të kryejnë kontrolle dhe verifikime, rast pas rasti, në depot e magazinimit, gjatë transferimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil dhe në magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë.

2. Policia e Shtetit vendos marrjen e masave administrative, me pezullim, gjobë apo heqjen e autorizimit në këto raste:

a) Kur gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara vëren se, pas pajisjes me autorizim, subjekti përgjatë ushtrimit të veprimtarisë humbet ose ndryshon kushtet dhe kriteret e përcaktuara për dhënien e autorizimit, vendos pezullimin e autorizimit deri në përmirësimin e kushteve.

b) Autorizimi për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse hiqet në rastet kur:

i) gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara vëren përsëritjen e pajustifikuar të shkeljeve, të përcaktuara në shkronjën "a";

ii) subjekti kryen vepër penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse, për përdorim civil, si dhe lëndëve piroteknike fishekzjarrë apo që cenon jetën dhe shëndetin e njeriut;

iii) Subjekti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë që lidhet me magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, lëndëve piroteknike fishekzjarrë, rrezikon jetën e kafshëve dhe mjedisin.

3. Dispozitat e kreut VII zbatohen edhe për subjektet që magazinojnë lëndë piroteknike fishekzjarrë.

4. Subjektet e interesuara mund të ankohen kundër masave administrative brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni në gjykatën administrative.

5. Subjekti, që shkel rregullat gjatë ushtrimit të veprimtarisë për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 209, datë 26.1.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për procedurën e dhënies së autorizimit për magazinimin, transportin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil", shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Policia e Shtetit, Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit, Reparti i Inspektim-Shpëtim-Minierave, si dhe institucionet e tjera të specializuara shtetërore, të parashikuara me ligj, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**